



Peaceful
Change
initiative



Gratë në media

Anketa Kosovë

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Gjetjet kryesore	4
Profili i të anketuarave	5
Mosha e të anketuarave	6
Punësimi dhe pagat	7
Pabarazia në të ardhura	8
Diskriminimi për shkak të pamjes	9
Ageism - Diskriminimi për shkak të moshës	10
Ngacmimi seksual: E lashë punën	11
Trajtimi i grave si objekte në redaksi: “Më është kërkuar të dukem më sensuale”	16
Perceptimet personale: Gazetaria merr nga jeta personale	17
Balanci punë - jetë i gazetareve	19
Stigmatizimi dhe paragjykimet: “Kaloj shumë kohë me burra”	22
Pushimi i lehonisë: Më ka lënë prapa	22
Portretizimi i grave në media	24
Rekomandimet	29
Mirënjohjet	30
Metodologjia	30
Rreth ALVED-it	31
Rreth PCI	32

HYRJE

Gjatë periudhës nëntor 2020 dhe dhjetor 2022, Iniciativa për ndryshim paqësor (Peaceful Change initiative – PCI) mbajti një seri dialogjesh konsultative të mediave (Media Consultation Dialogues) ku morrën pjesë shumë profesionistë të medias nga Kosova dhe Serbia. Në dhjetor të vitit 2021, ne organizuam Dialogun Konsultativ të Mediave për “Gratë nëpër redaksi”. Ne mblodhëm në formatin online një grup gazetarësh kosovarë dhe serbë, për t’i dëgjuar reflektimet e tyre lidhur me pozitën e grave në media, statusin e tyre, mundësitë për avancim, çështjet specifike që lidhen me gjininë si: dhuna seksuale në vendin e punës dhe se si e perceptojnë ata(o) përfaqësimin gjinor në media.

Takimi u zhvillua kur pandemia COVID-19 ende ishte një pjesë e ngatërruar e jetës, punës, aktiviteteve dhe e diskutimeve tona të përditshme. Tashmë ishim dëshmitarë se si virusi i përkeqësoi më tej pabarazitë, pasi që shumë nga përvojat e fshehura të krizës ishin të aspektit gjinor: duke filluar nga rritja e barrës së punës së papaguar e deri tek rritja e numrit të rasteve të dhunës me bazë gjinore. Po ashtu, ishte koha kur ishim dëshmitarë se si gratë qenë në vijën e parë të frontit kundër pandemisë, si arkëtarët nëpër dyqanet ushqimore dhe infermieret në kujdesin shëndetësor. Në mesin e atyre që ishin në vijën e parë të frontit ishte edhe një grup i veçantë: gazetarët që raportonin për virusin që nga koha e shpërthimit të tij.

Prania në ekran e reportereve konfirmoi edhe një herë diçka që punëtorët e mediave tashmë e kanë thënë brenda rrethëve të tyre: se gratë përbëjnë shumicën e gazetarëve në terren në Kosovë. Megjithatë, redaksitë në Kosovë, jo vetëm që nuk arritën ta përdornin fuqinë dhe ndikimin e tyre për t’i sfiduar normat tradicionale sociale dhe kulturore që e vazhdojnë në pambarim shtypjen e grave, por shpesh përfundojnë duke i përforcuar dhe mirëmbajtur perceptimet dhe stereotipet e dëmshme gjinore.

Kjo gjë u sugjerua edhe nga gazetarët gjatë diskutimit ku u theksua fakti se si redaksitë nuk po arrijnë t’i përfshijnë perspektivat, përvojat dhe zërat e grave në produksionet e tyre mediale. Por theksuan se redaksitë po dështojnë edhe me to, pasi që pabarazia gjinore dhe seksizmi nuk janë vetëm pjesë e titujve, por edhe e vendit të tyre të punës.


Ky raport rrjedh nga vetë pjesëmarrëset, të cilat shprehën nevojën për një anketë që do të përqendrohej në pozitën e grave në media dhe që do të ofronte një pasqyrë më të mirë të (pa) barazisë gjinore nëpër redaksi.

Shpresojmë që gjetjet e kësaj ankete do të hapin rrugën për këtë bisedë.

GJETJET KRYESORE

- Rreth **50 përqind** e grave të anketuara (në tekstin e mëtejshëm: të anketuarat) fitojnë më pak se mesatarja kombëtare;
- **39.2 përqind** e tyre punojnë më shumë se 40 orë në javë;
- Më shumë se **40 përqind** e gazetareve të anketuara mbulojnë politikën, në kundërshtim me pohimet se është një fushë që dominohet nga burrat, e cila vihet në zbatim veçanërisht gjatë paneleve televizive të mbrëmjeve të njohura (që ne i quajmë “panelet me burra”) që mbeten seksiste dhe ekskluzive vetëm për burrat;
- **21.5 përqind** besojnë se fitojnë më pak se kolegët e tyre burra për të njëjtën punë;
- **26.4 përqind** ose një në katër gra ishte viktimë e ngacmimit seksual. Disa të anketuara deklaruan raste të sulmeve seksuale;
- **20 përqind** kanë qenë të diskriminuara për shkak të pamjes dhe **28.3 përqind** për shkak të moshës;
- **49.1 përqind** mendojnë se jeta e tyre private ka pësuar për shkak të punës dhe **29.1 përqind** mendojnë se jeta e tyre private ndikon në masë të madhe në punën e tyre;
- **70 përqind** besojnë se gratë janë më pak të pranishme se burrat në përmbajtjet mediatike;


Ndoshta gjetja më ilustruese është se 44.2 përqind e të anketuarave nganjëherë, e 29.4 përqind e të anketuarave shpesh **mendojnë që ta ndërrojnë vendin e punës** - kjo në fakt nënkupton se për një arsye ose një arsye tjetër, gati 70 përqind e grave të angazhuara nëpër redaksi janë të pakënaqura me profesionin e tyre ose me punën që ato bëjnë.



Në përgjithësi, të gjitha këto gjetje janë në përputhje me hulumtimet periodike globale mbi statusin e grave në media, që tregojnë përfaqësim të pabarabartë në pozitat drejtuese dhe në përmbajtjet mediatike, pamundësinë për të përshtatur jetën e tyre private dhe karrierën, si dhe diskriminimin. Megjithatë, ajo që i jep një “ngjyrë” të veçantë këtij hulumtimi u shpëton statistikave – janë dëshmitë tronditëse rreth abuzimit seksual, pakënaqësitë, ndjenja e mos përmbushjes në këtë fushë apo ndonjë tjetër, të cilat edhe po i ndajmë dhe përcjellim këtu pjesërisht.

PROFILI I TË ANKETUARAVE

Në radhët e të anketuarave kishte gazetare, fotoreportere, lektore, redaktore, kryeredaktore, drejtoresha, si dhe drejtuese të punësuar në të gjitha llojet e mediave.




Sipas një ankete ka dy herë më shumë gazetare se sa redaktore, ndërsa pozita e kryeredaktoreve përbëjnë një përqindje shumë të ulët. Prapëseprapë është e vështirë të vihet në përfundim nëse gratë ende përballen me shanse të mëdha si tavani i qelqtë në vendet e punës në media, pa pasur të dhëna statistikore mbi pozitat kryesore redaktoriale nëpër redaksi dhe që të shohim nëse ka ndonjë pabarazi në pozitat drejtuese.


Një raport nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) konfirmon se nuk ka të dhëna statistikore për pozitat udhëheqëse redaktoriale nëpër redaksi, por se gazetaret kanë më shumë gjasa të mbajnë poste si redaktore nëpër redaksi, veçanërisht në mediat kryesore, ndërsa gazetarët janë më shumë përgjegjës për sektorin drejtues. Asnjë nga të anketuarat nuk mban pozitë drejtuese.

Përfaqësimi i dobët i grave në debate në kanalet televizive të lajmeve ka qenë një çështje e rëndësishme që është ngritur dhe theksuar shpesh nga komuniteti i gazetarëve në Kosovë. Por mungesa e grave në ekrane është në kontrast të plotë me praninë vizuale gjatë lajmeve televizive, ku gratë përbëjnë shumicën e gazetarëve në terren.

Nga 265 të anketuara gati gjysma sosh punojnë në për stacione televizive.




Numri i lartë i grave që punojnë në një stacion televiziv përkon me daljen në skenë të mediave të reja gjatë viteve të fundit në Kosovë. Kjo e dhënë përkon edhe me një përqindje të lartë të grave që mbulojnë politikën, pasi zakonisht janë gratë ato që raportojnë jashtë studiove për zhvillimet e përditshme politike. Në fakt, një nga gjetjet më interesante të anketës është numri i lartë i gazetareve që mbulojnë politikën, që pasohet nga kultura dhe argëtimi/moda, çështjet sociale, ekonomia e të tjera.



MOSHA E TË ANKETUARAVE

Gratë që e kanë plotësuar anketën ishin të moshës prej 18 deri në 65 vjeç (që është moshë e pensionimit në Kosovë).




Demografia e të anketuarave tregon se një përqindje e madhe e gazetareve janë nën moshën 40 vjeç. Kjo mund t'i atribuohet faktit se zgjerimi i medias në Kosovë ka ndodhur veçanërisht në dekadën e fundit, por edhe kushteve të punës si pagat e ulëta, vështirësitë e gazetareve për të vazhduar karrierën e tyre, si dhe kërkesat e mëdha brenda jetës së tyre familjare, barra e punës së papaguar dhe mungesa e çdo sigurie sociale. Shumë nga këta faktorë sugjerohen edhe nëpërmjet gjetjeve të anketës dhe gjenden në kapitujt e ardhshëm të raportit.

PUNËSIMI DHE PAGAT

Në rreth 50 përqind të rasteve, paga e të anketuarave është më e ulët se mesatarja për Republikën e Kosovës. Sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, të ardhurat mesatare mujore në sektorin publik në Kosovë janë 542 euro, ndërsa paga mesatare në sektorin privat është 376 euro, duke e bërë atë një nga pagat mesatare më të ulëtat në Evropë.


Gati 40 përqind e të anketuarave kanë thënë se pagat e tyre janë nën 600 euro, 27.2 përqind kanë pagë nga 600-800, 17.4 përqind kanë pagë mes 800-1000 dhe vetëm 9.1 përqind e të gjitha të anketuarave kanë pagë mbi 1,000.



Kur të dhënat grumbullohen më tej, anketa konfirmon një mjedis më të keq ekonomik për punonjësit e medias që punojnë në një portal lajmesh online. Për shembull, gjersa 19 përqind që punojnë në një stacion televiziv kanë pagë nga 800-1000 euro, vetëm 5.5 përqind e atyre që punojnë në një portal lajmesh kanë të njëjtën pagë.


Dallimi vërehet edhe kur bëhet krahasimi i pagave më të ulëta dhe atyre më të larta: 5.6 përqind e të anketuarave që punojnë në një stacion televiziv kanë pagë nën 300 euro, ndërsa nja 5.6 përqind e tyre kanë pagë mbi 1000 euro. Ndërkohë, 9 përqind e tyre që punojnë në një portal lajmesh kanë pagë nën 300 euro dhe vetëm 3.6 përqind e kanë mbi 1000 euro.

Përgjigjet e të anketuarave konfirmojnë po ashtu perceptimin e madh të disa vështirësive të tjera me të cilat ballafaqohen gazetaret në vendin e punës, siç janë orët e gjata të punës, ku pak më pak se 40 përqind sosh janë që punojnë mbi 40 orë në javë.



PABARAZIA NË TË ARDHURA

Të anketuarat u pyetën nëse kishin të ardhura më të ulëta në krahasim me kolegët e tyre burra, 21.5 përqind e tyre janë përgjigjur me po.




Kur të dhënat grumbullohen më tej për të kuptuar profilin e të anketuarave që përbëjnë 21.5 përqind, rezultojnë se 51.8 përqind janë gazetarë dhe 19.6 përqind redaktore. Ato punojnë kryesisht ose në stacione televizive ose në portalet e lajmeve. Një tjetër e dhënë e përmbledhur gjen se 30 përqind e atyre që mendojnë se janë të diskriminuara në aspektin gjinor sa u përket të ardhurave të tyre, e mbulojnë politikën, të pasuara nga 23,4 përqind sosh që mbulojnë kulturën dhe 16,1 përqind, çështjet sociale.

Në mungesë të informacionit mbi pozitën ekonomike të punonjësve burra të medias, është e vështirë të vihet në përfundim nëse pagat e pretenduara nga të anketuarat janë diskriminuese në aspektin gjinor. Sipas raporteve të AGK-së, pagat e gazetarëve nuk dallojnë nga ato të kolegëve të tyre burra. Por përqindja prej 21.5 duhet të merret në konsideratë, duke treguar kështu nevojën për një analizë tjetër që do të shqyrtonte hendekun gjinor në paga brenda sektorit të medias.

DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PAMJES


20 përqind e të anketuarave kanë thënë se janë diskriminuar për shkak të pamjes së tyre. Një përmbledhje e profileve që u përgjigjën me “Po” tregon se moshat më të reja dhe ato më të vjetra kanë më shumë gjasa të ndjehen të diskriminuara për shkak të pamjes. 24,6 përqind e të anketuarave të moshës 18-24 vjeç dhe 28.6 përqind e të anketuarave të moshës 45-54 vjeç u përgjigjën me ‘Po’, krahasuar me 20,5 përqind të të anketuarave të moshës 25-34 vjeç dhe 14,5 përqind të të anketuarave të moshës 45-54 vjeç.



Të dhënat e grumbulluara tregojnë se të anketuarat nga mosha më e re (18-24 vjeç) dhe mosha më e vjetër (45-54 vjeç) ka të ngjarë të ndjejnë më shumë diskriminim për shkak të pamjes së tyre krahasuar me të tjerat. 24,6 përqind e të anketuarave të moshës 18-24 vjeç dhe 28,6 përqind e të anketuarave të moshës 45-54 vjeç thanë se ishin diskriminuar për shkak të pamjes së tyre, krahasuar me 20 përqind të të anketuarave të moshës 25-34 vjeç dhe 14,5 përqind të të anketuarave të moshës 35-44 vjeç.

AGEISM - DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS

28.3 përqind e të anketuarave kanë deklaruar se janë diskriminuar për shkak të moshës së tyre.



Një përqindje shumë më e vogël e grave më të moshuara janë në fuqinë punëtore krahasuar me burrat më të moshuar në tregun e punës në Kosovë, por mungesa pranisë vizuale në ekran të gazetareve më të moshuara sugjeron se edhe redaksitë nuk po i akomodojnë gazetarët(et) më të moshuar dhe me më përvojë.

Të dhënat e grumbulluara tregojnë një trend të ngjashëm me përgjigjet në pyetjen rreth diskriminimit për shkak të pamjes së jashtme. Ngjashëm me këtë, të anketuarat më të reja dhe më të vjetra kanë më shumë gjasa të ndjehen të diskriminuara për shkak të moshës. 36.2 përqind e të anketuarave të moshës 18-24 vjeç dhe 42.9 përqind e të anketuarave të moshës 45-54 vjeç thanë se ishin të diskriminuara për shkak të moshës, krahasuar me 30 përqind të të anketuarave të moshës 25-34 vjeç dhe 14.5 përqind të të anketuarave të moshës 35-44 vjeç.

Nevojitet një analizë e plotë për të kuptuar se deri në çfarë mase gratë në organizatat e lajmeve janë të ekspozuara ndaj diskriminimit për shkak të moshës. Por, disa të anketuara dhanë prova të qarta se si reporteret më të reja kishin përjetuar diskriminim për shkak të moshës.


Dëshmitë:

“Sepse isha e shumë e re (sipas tyre) të raportoja e të shkruaja për politikë.”

“Pamja dhe mosha (e re) kanë bërë që në disa raste të mos merrem seriozisht aq sa duhet nga disa zyrtarë të institucioneve, të cilët kanë menduar se shkak i moshës nuk jam person adekuat për trajtimin e disa temave. Mirëpo, të njëjtëve iu është treguar e kundërta”

NGACMIMI SEKSUAL: E LASHË PUNËN

Studimi gjeti se 1 në 4 punonjëse gra të mediave kosovare janë viktima të ngacmimeve seksuale në vendin e tyre të punës. Nga 265 të anketuara, 70 ose 26.4 përqind e të anketuarave u përgjigjen me PO në pyetjen nëse kanë qenë ndonjëherë viktima të ngacmimit seksual në lidhje me punën e tyre.



Pavarësisht dëshmimeve nga përvoja dhe vëzhgimet personale sa i përket përhapjes së tij të vazhdueshme, përvojat e ngacmimeve seksuale të gazetareve nuk ishin dokumentuar më parë. Për herë të parë, gjetjet e anketës konfirmojnë se gratë që punojnë nëpër organizata të ndryshme të lajmeve në Kosovë u nënshtrohen ngacmimeve dhe viktimizimit seksual.

Nga 70 të anketuara që deklaruan se janë viktima të ngacmimeve seksuale, 64,7 përqind punojnë në një stacion televiziv, 17,6 përqind punojnë në një media online, 4,4 përqind në një gazetë të përditshme, 3 përqind në një stacion radiofonik dhe pjesa tjetër punojnë në platforma të tjera mediatike.

Të dhënat tregojnë se gratë e të gjitha moshave dhe e të gjithë sektorëve janë viktima të ngacmimit seksual: 47,1 përqind e të anketuarave janë të moshës 25-34 vjeç, 32,4 përqind janë të moshës 18-24 vjeç, 17,6 përqind janë të moshës 35-41 vjeç dhe 2,9 përqind janë të moshës 45-54 vjeçare.

Më shumë se gjysma e të anketuarave - 57,4 përqind - që kanë pësuar ngacmime seksuale në vendin e punës janë gazetare. Redaktoret përbëjnë 25 përqind të të anketuarave, ndërsa prezantueset, producentet dhe llojet e tjera të pozitive përbëjnë pjesën tjetër të grave që janë viktima të ngacmimeve seksuale. Të dhënat e përmbledhura tregojnë se 27,9 përqind e të anketuarave mbulojnë politikën, 20,6 përqind mbulojnë kulturën, 17,6 mbulojnë çështjet sociale, ndërsa të anketuarat e tjera mbulojnë tema të tjera në gazetari.

Përkundër faktit se pyetësi nuk përmbante pyetje më specifike për kryesit e veprave, të anketuarat që iu përgjigjën me PO pyetjes nëse kanë qenë ndonjëherë viktima të ngacmimit seksual, kishin hapësirën dhe mundësinë që të jepnin informata të mëtejshme të hollësishme për sa i përket përvojës së tyre.

Më shumë se 50 sosh dhanë përshkrime të hollësishme të përvojave të tyre të ngacmimit duke ndihmuar që të kuptohet më mirë se si ky diskriminim me bazë gjinore është një shqetësim serioz në shumë media dhe organizata të lajmeve në Kosovë. Gazetaret të cilat ishin ngacmuar seksualisht në punë, përshkruan raste të ndryshme të ngacmimeve seksuale që sillen nga bisedat me ngjyrimet seksuale e deri tek kërkimet e favoreve seksuale. Ato raportuan se në kryesit e veprave hyjnë kolegët e tyre burra dhe burimet e lajmeve.

Një numër i konsiderueshëm deklaruan se bashkëpunëtorët e tyre burra, si kolegë gazetarë, kryeredaktorë, regjisorë, kameramanë dhe montazherë i ngacmonin ato seksualisht. Shembujt e ngacmimeve seksuale, madje edhe brenda redaksisë silleshin nga gjestet e papërshtatshme ose të padëshiruara seksuale, pushtimi i hapësirës personale në mënyrë seksuale, bërja e komenteve apo shakave seksuale apo shtruarja e pyetjeve seksuale e deri te ngacmimet përmes mesazheve me tekst dhe prekjes. Disa gazetarë raportuan edhe forma të sulmit seksual, si përkëdheljet ose prekjet seksuale të padëshiruara.

Shumica e kryesve të veprave të tilla jashtë redaksive përfshijnë burra që mbajnë poste publike në institucione dhe parti politike si politikanë dhe zyrtarë, por edhe biznesmenë dhe të intervistuar burra të cilët ishin burime të rëndësishme në storiet në të cilat punonin gazetaret.

Disa të anketuara raportuan se ishin viktimat të formave të ndryshme të ngacmimit seksual, ndërsa disa të tjera deklaruan se kishin përjetuar dhunë dhe ngacmim në punë disa herë.

Në anketë të anketuarat nuk u pyetën nëse ato e kishin raportuar ngacmim seksual te mbikëqyrësit e tyre ose personat me autoritet vendim-marrës. Megjithatë, disa të anketuara, deklaruan se ato ishin pritur me dekurajim dhe indiferencë kur e raportuan dhunën seksuale ndaj tyre te mbikëqyrësit e tyre.

Një grua u sulmua seksualisht nga burimi i saj dhe redaktori nuk arriti të ofrojë asnjë mbështetje psikologjike.

Përvoja e frikshme dhe traumatizuese e shkaktuar nga ngacmimi seksual në vendin e punës ilustron sidomos në këto dy përgjigje:

“E lashë punën.”

“Hoqa dore nga vendi i punës për të cilin konkurrova.”

Dëshmitë:

“Gjatë intervistimit të palëve (njerëzve të ndryshëm), jam ngacmuar disa herë.”

“Kryesisht ka pasur të bëjë me trajtimin tim si grua si objekt nga redaktorët e mi, në një gazetë të njohur, të shprehura verbalisht. Asokohe nuk i kam trajtuar si duhet, por kemi të bëjmë me ngacmime seksuale verbale.”

“Nuk ka ndodhur në ambientet e redaksive të mediave ku kam punuar, por në raste të ndryshme në terren nga personazhe të kronikave që kam punuar, nga përfaqësues politikë e më poshtë. Ka pasur raste që kanë dhënë komente për pamjen që për mua kanë qenë ngacmim seksual, apo shumë raste që pasi ke përfunduar intervistën, të ka shkruar pas orarit në orët e vona të mbrëmjes, madje duke krijuar ‘private chat’ në aplikacionin ku shkruante. Dhe më e keqja nuk ke si t’i shmangesh kontaktit me këta persona sepse pozita institucionale që ata mbajnë e bën të kesh përsëri punë me ta.”

“Gjatë punës në terren, gjatë disa muajve, në dy raste kam hasë në ngacmime seksuale. Rasti i parë me një njohës të ekonomisë i cili gjatë prezantimit të temës për të cilën do të flisnim, më tha “të shkojmë tek lumi”, si duke qeshur. Të pranishëm me mua kanë qenë dy kameramanë. Megjithatë, rastin e tejkaluam në heshtje.

Ndërsa rasti i dytë me një fermer, i cili pasi përfunduar xhirimet, i tha kameramanit të shkonte, ndërsa mua m'u drejtua “rri ti, hyp në traktor a ku të dush, knaqemi”, kështu disi. Edhe këtë rast e tejkaluam në heshtje bashkë me kolegun tim. Të dyja rastet i kam raportuar menjëherë sapo jam kthyer në redaksi.”

“Ngacmimi seksual ka ndodhur në vendin e punës, me shkrime të papërshtatshme, e kohë pas kohe thirrje të shumta telefonike nga kolegët e mi.”

“Një prej rasteve ka qenë me një prej personave që kam intervistuar. Në fillim intervista më është ndërprerë disa herë nga komentet e personit, duke komentuar duart, buzëqeshjen, e të tjera. Më pas situata ka eskaluar kur unë në shenjë revolte desha të çohem nga tavolina dhe ta ndërpres bisedën, kur personi u ul afër meje dhe tentoi të fus duart mes këmbëve të mia. Reagimi im ka qenë i menjëhershëm duke e larguar nga vetja dhe jam kthyer në redaksi e shokuar me atë se çfarë ka ndodhur. Reagimi i redaktorit tim ka qenë ky: “Më vjen shumë keq që të ka ndodhë kjo, por nëse nuk ndjehesh me e shkru shkrimin mos e shkruaj”. Do të thotë e gjithë ajo traumë nëpër të cilën kisha kaluar, kaloi si një tjetër ditë në vend të punës, vetëm se në rastin konkret mu dha e “drejta” të vendos nëse dua apo jo ta përfundojë artikullin.”

“Në median e parë kur kam punuar si gazetare, një koleg mbi moshën 50 vjeçare, më ka ngacmuar me fjalë herë pas here. “Ta hëngsha heshtjen”, ka qenë fjala që ma ka dërguar në rrjete sociale, kur unë kam qenë duke punuar, e nuk kam folë.”

“Kam qenë shpesh viktimë e ngacmimit seksual në vendin e punës dhe jashtë vendit të punës. Në mesin e ngacmuesve mund të përfshijë redaktorë, kolegë, ndërsa jashtë vendit të punës zyrtarë të ndryshëm, përfshirë edhe politikanë.”

“Një koleg ka tentuar të më puth. Ai me ofroi të më afronte deri në stacion të autobusëve sepse binte shumë shi. Ishte pasdite, ora 5 - përfundimi i orarit të zakonshëm të punës. Kur nisa te dal nga vetura tentoi të më puthte. Njiheshim mirë, ishte ndër njerëzit e rrethit të afërt në zyrë.”

“Përdorimi i gjuhës së papërshtatshme nga ana e eprorit.”

“Drejtorët e kanë shfrytëzuar pozitën e tyre dhe në mënyrë superiore kanë dhënë komente seksiste, ngacmuese ndaj meje.”

“Gjatë punës në redaksi - kam pranuar avancime të padëshiruara dhe të paftuara prej autorëve kontribues burra. Kjo ka qenë në mesazhe dhe në përgjigje. E kanë keqpërdorë numrin tim për të më shkruar mesazhe të natyrës seksuale, kur natyra e punës tonë ka qenë strikt profesionale.”

“Ka ndodhur një herë dhe para më shumë se tre vjetësh, kur po bashkëpunoja për një temë me një burim të informacionit. Ngacmimi ka ndodhur në veturë, kur i njëjti ka prekur krahun tim, si duke qeshur e bërë shaka, gjest i cili ka tejkalu kufijtë e marrëdhënies tonë të bashkëpunimit profesional. Në gjykim të parë edhe mund të tingëllojë e hiperbolizuar, por situata e krijuar nga të qeshurat, e folura dhe në fund prekja, të asocion me ngacmim. Këtë bindje e ka përforcuar edhe më shumë tendenca e tij më pas për të biseduar, pas zgjedhjes sime për të mos ju përgjigjur.”

“Shikime provokuese, prekje të belit.”

“Në terren kemi shpesh ngacmime seksuale e fjalë fyese, si p.sh. rasti fundit ka qenë gjatë intervistave në terren në një lagje... Disa djem kanë bërë titull me të madhe: Oj gazetare ta honksha p..in, ti honksha cicat, etj.”

“Në fillimet e punës time si gazetare ka pasur ngacmime nga kolegët, por që i kam tejkalluar duke i injoruar.”

“Gjatë takimeve me bashkëbisedues më ka ndodhur të marrë komente seksiste, por edhe ngacmim seksual.”

“Nuk mendoj që gjatë punës si gazetare kam qenë e ngacmuar seksualisht, mirëpo gjatë përvojës në punë dhe në studime, në Kosovë, kam qenë gjithmonë e pasigurt sidomos gjatë punës në terren. Edhe nëse bashkëpunëtorët e mi, kolegët, i njihja mirë, gjithmonë në terren kam qenë e rrethuar me burra, që rrjedhimisht më ka shty me qenë gjatë tërë kohës e kujdesshme, e njëkohësisht (fatkeqësisht) e frikësuar.”

“[Ka ndodhur] në forma jo direkte, brenda mediave dhe jashtë gjatë detyrës si gazetare. Ftesa të paarsyeshme për dreka e darka, komplimente të panevojshme!”

“Ngjarja ka ndodhur në terren. Isha në fillimet e punës sime si gazetare, rrugës për në terren kur kameramani bëri komente seksuale për pamjen time fizike.”

“Ngacmime nga kolegë të caktuar, të cilët pa hezitim japin komplimente (që si bazë kanë flirtimin) lidhur me dukjen e jashtme pa pasur fare nevojë për komente të tilla. Kjo pasi që mua më shqetësojnë dhe më bëjnë të ndihem jo rehat në vendin tim të punës.”

“Gjatë kohës sa po e punonim bashkë një storie me një montazher, montazheri nis dhe e komenton pamjen time fizike si “sa t’bukur i ki sytë, shumë mirë po t’rrin qeto farmerka, e kështu që sa kohe je e fejume?”, edhe në momentin që unë i them me vazhdu punën mos me jep komente rreth pamjes time edhe mos me bo pyetje personale, ai më thotë mos me i tregu çka me bo “se unë muj me bo çka t’du me ty”. Në atë moment ndërpritet puna dhe nuk merren menjëherë masa ndaj tij, por pas edhe disa ngacmimeve të tjera me kolegët e tjera montazheri largohet nga puna.”

“Gjatë kohës në terren duke marr mendime nga qytetarët për temën që po trajtoja, disa persona më kanë ngacmuar me fjalë seksuale, përveç kësaj më ka ndodhur tri herë që personi me të cilin kam pasur intervistë të më ngacmojë përmes thirrjeve, duke më bërë komente seksiste, si p.sh “ndërro foton e viberit se nuk po mundem me duru, me këtë fytyrë e bën për vete edhe princin.....”

“Po e realizoja një intervistë me një person dhe pas intervistës ma vuri dorën në këmbë dhe filloi të flasë me fjalë ledhatuese.”

“Komentet aspak të hijshme gjatë punës në terren nga njerëzit. Sidomos kur të shohin që je vajzë dhe mbanë mikrofoni menjëherë të vishet një hije ‘e përdalë’ nga ana e tyre”

“Ka pasur raste kur pas intervistave, si rezultat i mirësjelljes tuaj si gazetare/prezantuese, të ftuarit e ndjejnë veten më rehat për të t’dhënë “komplimente” për dukjen e të cilat në disa raste edhe vazhdojnë përmes rrjeteve sociale, në mënyrë “shoqërore.”

“Në një rast nga një koleg i imi, dhe një rast tjetër me një person publik (biznes).”

“Provokimet nga ana e bashkëbiseduesit.”

“Ka ndodhë të ngacmohem seksualisht gjatë punës si gazetare në terren, qofshin ato direkte, por edhe me mesazhe të ndryshme!”

“Në katër media sa kam punuar, pothuajse në secilën më ka ndodhur të marr komente seksiste dhe ngacmime seksuale përmes gjuhës së përdorur apo edhe shikimeve. Kryesisht kjo ka ndodhur nga kolegët gazetarë, por ka pasur raste edhe nga drejtori i mediumit dhe kryeredaktori. P.sh., një rast më ka ndodhur me kryeredaktorin në një media, i cili vazhdimisht më komplimentonte për dukjen, në prani edhe të kolegëve të tjerë, dhe në një rast gjatë komunikimit në Facebook, më pati thënë që “dukesh shumë sexy”.

“Ngacmime seksuale ka, por tanimë mundohem t’i përbijë a anashkaloj. Kam pas rast e cili ka përfunduar me ndërmjetësim.”

“Nëse ngacmim llogaritet edhe pëlqimi i hapur ndaj meje, ani pse kam qenë në detyrë, atëherë po.”

“Ngacmime me fjalë, ftesa për takime.”

“Nuk më ka ndodhur ende, sepse besoj që kam pak kohë që punoj, por kam dëgjuar nga shumë kolege për ngacmime.”

“Secila gazetare me cilindo kontakt dhe burim që e kontakton, dhe pastaj duhet të mbajë takim me ta, ngacmohet në çfarëdo mënyre si me shikim të trupit, si me ngacmim verbal, pastaj edhe nëpër rrjete sociale.”

“Ftesa të pareshtura për kafe, insistime për dalje, shoqëruar me komente të papërshtatshme dhe reagime jo etike karshi refuzimeve të këtyre ftesave. Madje në një rast, edhe ofendime të ulëta. E njëjta situatë është përsëritur, pak muaj më vonë me një tjetër kolege...”

“Disa nga bashkëbiseduesit të cilët i kam intervistuar gjatë periudhave të ndryshme kohore, më kanë ftuar edhe për kafe. E di që nuk është asgjë të pish një kafe me ata që i interviston, por qëllimi i tyre dukej qartë që ishte më shumë se një kafe. Rasti konkret: kam intervistuar një zyrtar në njërin nga ministritë, pas intervistës fjalët e tij ishin: Eja ndonjëherë edhe për kafe në Ministri, jo vetëm për punë. Përgjigja nga ana ime ishte që “ju jeni zyrtar dhe unë gazetare, pikërisht për këtë çështje je i obliguar të na përgjigjesh profesionalisht, për kafe unë kam shoqëri jashtë këtij institucioni.”

“Ngacmime seksuale ka pasur në punë, nga zyrtarët me të cilët jam takuar. Ka qenë një rast me një avokat që më shumë më vjen marre mu për gjestin e tij, sesa atij për atë gjest. Kur ka deshtë me m’përqaftu, kur kam reaguuar, ka thënë “mos më keqkupto se si vajzën tim të shoh”. Por, nuk ka qenë ashtu. Njeri manjak.”

“Pas intervistës që realizova me një person që dikur mbante pozitë shtetërore, i njëjti vazhdoi duke më komentuar në detaje për pamjen time, gjë kjo që më vuri shumë në siklet, ai po ashtu vazhdoi duke më treguar vendin ku ai banon, e duke më kërkuar që sa herë që unë të kisha nevojë për të, jo vetëm intervista, ta thërras në telefon.”

“Në çdo vend pune ka pasur ndonjë njeri.”

“Nuk është vetëm njëherë, gati çdo ditë gratë ngacmohen, qoftë me fjalë edhe me shikime, mimika të fytyrës/shtrëngime duarsh/shkelje syri. Kjo ndodhë edhe kur jeni me shumë persona, edhe kur p.sh., jemi dy gazetarë, apo bashkë me kameramanin.”

“Viktimë e ngacmimit seksual nuk kam qenë nga kolegë (burra) që janë në televizionin ku punoj, ndërsa gjatë punës si gazetare në terren nga persona të ndryshëm, po!”


“Paraqita rastin tek njerëzit kompetent. Atij personi iu ndërrua pozita.”

TRAJTIMI I GRAVE SI OBJEKTE NË REDAKSI: “MË ËSHTË KËRKUAR TË DUKEM MË SENSUALE”

Përveç dëshmime të shumta se si gazetaret shihen si objekte dhe ngacmohen seksualisht në vendin e tyre të punës, ka edhe dëshmi se përveç parashtrimeve të padëshiruara seksuale, gazetaret trajtohen si objekte edhe nga mbikëqyrësit e tyre për qëllime të produksionit të lajmeve. Ky trajtim i gazetaresve si objekte brenda redaksive ilustron veçanërisht në përgjigjet që të anketuarat dhanë kur u pyetën nëse kanë përdorur ndonjëherë “atributet e tyre femërore” për të marrë informata dhe intervista.

Megjithëse gratë u përgjigjën në masë dërmuese me JO - 92.1 përqind thanë se nuk i kanë përdorur kurrë “atributet e tyre femërore” për të marrë informata ose intervista - megjithatë disa shpjegime të ofruara ndihmojnë për të kuptuar natyrën e trajtimit si objekte që gratë e përjetojnë brenda redaksisë.

Një e anketuar tha: “Pronari më ka kërkuar të bëj makijazh më shumë që të dukem mirë në kamerë.”



Dëshmitë:

“Po, më është kërkuar që kur të kem intervistë me artistë të jem pak më sensuale dhe tërheqëse.”

“Po, shpesh herë edhe më është kërkuar nga redaktorët ose shefat e tjerë që unë të përdor ndonjë taktikë për ta bindur intervistuarin.”

Disa të anketuara vunë në pah edhe normalizimin shqetësues të trajtimit të grave në kuadër të redaksisë si objekte dhe vështirësinë për ta luftuar këtë kulturë në vendin e punës:

“[Po e kam përdorur “sharmin femëror”] sepse jetojmë në një vend - shtet ku meritokracia mungon.”

“Për të zbutur situata të tensionuara.”


“Kur e kanë kuptuar që jam gazetare kanë pasur vullnet më të madh për t’u përgjigjur.”

“Nuk jam përgjigjur me PO, mirëpo në përgjithësi e kam vërejtur që unë e kisha më të lehtë të merrja informata sesa kolegët e mi burra.”

PERCEPTIMET PERSONALE: GAZETARIA MERR NGA JETA PERSONALE

Meqenëse gazetarët(et) punojnë nën shumë stres dhe presion dhe kalojnë orë të gjata dhe të paparashikueshme, të anketuarat u pyetën nëse kanë sakrifikuar ndonjëherë jetën e tyre personale për shkak të punës. Nuk është për t'u habitur që përgjigjet e të anketuarave sugjerojnë se për shumicën e gazetarëve puna është kërkuese, rraskapitëse dhe u pengon të kenë një jetë të veçantë jashtë zyrës së tyre.

Gati të gjitha të anketuarat thanë se në njëfarë mënyre e kishin sakrifikuar jetën e tyre personale për shkak të gazetarisë. Gati 50 përqind thanë se shpesh duhej të sakrifikonin jetën e tyre personale, dhe më shumë se 40 përqind sosh thanë se kjo ndodhte ndonjëherë.



Pranohet në mbarë botën se gazetaria është një nga punët më rraskapitëse dhe stresuese mendërisht, si për gratë ashtu edhe për burrat. Në dritën e kësaj dhe në mungesë të të anketuarve burra, është e vështirë të vihet në përfundim nëse disa përvoja të rënda janë sipas gjinisë apo jo. Por të anketuarat, përmes reflektimeve të tyre, treguan me detaje se sa po ndikon profesioni i tyre në jetën e tyre. Ato gjithashtu sugjerojnë se mjedisi mediatic në Kosovë është armiqësor ndaj punëtorëve, të drejtat e të cilëve shkelen sistematikisht.

Dëshmitë:

“Puna në gazetari ndonjëherë kërkon angazhim përtej një orari të caktuar, për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin, prandaj ka raste kur puna vendoset përpara njerëzve të sipër përmendur.”

“Shumicën e kohës jam në punë dhe s’kam kohë sa unë dua për familjen apo shoqërinë.”

“E sakrifikon veten dhe jetën personale. Kjo për shkak të orëve të tej zgjatura të punës, mos kompensimi i kësaj mbi paragjykimin se gazetaria kërkon angazhim 24/7, dhe duke ditur natyrën e punës redaksitë ku kam punuar nuk e kanë marrë fare parasysh angazhimin përtej 8 orëve. Në anën tjetër, përgjegjësia profesionale të kufizon shumë në aspekt personal.”

“Gazetaria kërkon të jesh vazhdimisht aktive dhe në gjendje gatishmërie, kështu që shpesh për shkak të zhvillimeve, sidomos gjatë përcjelljes së punës së Kuvendit të Kosovës, kam humbur ditëlindjet e me të dashurve të mi, apo shumë data tjera të rëndësishme. Ngjarjet e paparashikuara, që e karakterizojnë punën tonë të përditshme, na bëjnë shpesh herë që të sakrifikojmë jetën tonë personale.”

“Po sigurisht. Për vite të tëra nuk kam mundur të dal pas orës 5 me shoqëri, nuk kam mundur t’i vizitojë prindërit aq herë sa kam dashur. Nuk kam mundur të jem e pranishme në ngjarje të rëndësishme në familjen time ose te të afërmit, apo edhe në raste të vdekjes së njerëzve që i kam dashur dhe respektuar.”

“Po, ka pasur raste kur më është dashur të punoj deri në mbrëmje vonë për shkak të ndonjë situatë politike edhe e kam lënë pas dore familjen dhe shoqërinë.”

“Në transmetime speciale për ngjarje të veçanta si zgjedhjet, ka pasur raste kur fëmijët si kam parë dy ditë.”

“Për shkak të natyrës së punës, sidomos si gazetare e kulturës ku shumica e ngjarjeve mbahen mbrëmjeve, është gati e pamundur të planifikohet diçka jashtë orarit të punës. Po ashtu për shkak të punës pa orar, gjithmonë mbi 8 orë në ditë e bën tepër të vështirë përkushtimin ndaj dikujt tjetër, e shumë shpesh edhe ndaj vetes.”

“Tetë vjet kam qenë kryeredaktore në televizion. Orari i gjatë, angazhimi i madh dhe lodhja, më ka mbajtur larg fëmijëve gjatë tërë ditës (deri në 19:30 pas edicionit qendror të lajmeve) dhe për rrjedhojë larg takimeve me familje e shoqëri gjatë mbrëmjeve.”

“Shpesh kam anuluar plane për shkak se nuk kam arritur ta kryej punën. Shpesh nuk kam shkuar në udhëtime personale për shkak të punës jashtë orarit (të pa paguar).”

“Puna në media është punë me presion dhe punë që nuk përfundon në orar të caktuar, detyrat dhe përgjegjësitë të përcjellin dhe në shtëpi e shoqëri kështu që mund të kem qenë e pranishme fizikisht por jo dhe me mendje, andaj në disa raste mendoj që ka qenë sakrificë.”

“Gjatë kohës që kam punuar si gazetare, shpeshherë kam punuar edhe gjatë fundjavave, pas orarit të punës, nuk kam kaluar kohë sa kam dashtë me familjarët e me shoqërinë. Puna ka qenë prioritet nëse kam dashtë me arritë me qëndru në një pozitë ma të përshtatshme”

“Nuk kam marrë pjesë në ditët e veçanta të fëmijëve, si dita e parë e shkollës.”

“Ka ndodhur kur kam pasur termine mjekësore, por më është dashur t’i shtyja për shkak se më ka ndryshuar orari i punës.”


“Kam stres të madh për shkak të punës, për atë nuk mundem ta shijoj kohën e lirë ashtu si dua.”

“Kryesisht ka ndodhur në festa kur është dashur të dalim në transmetim drejtpërdrejt dhe ndonëse ligji i punës e kërkon, asnjëherë nuk jemi kompensuar në çfarëdo mënyre. Por, edhe plane të zakonshme familjare të cilat më është dashur t’i anuloj për shkak të ndryshimeve të momentit dhe tej zgjatjes së orarit të punës.”

BALANCI PUNË - JETË I GAZETAREVE


Ndonëse një grup i konsiderueshëm i të anketuarave thanë se shpesh u është dashur t'i sakrifkohen marrëdhëniet e tyre me të tjerët për shkak të angazhimit në punë, një grup tjetër i të anketuarave kanë thënë se po përballen me shumë vështirësi në arritjen e avancimit në karrierë për shkak të jetës familjare.

Gati 30 përqind thanë se përgjegjësitë e tyre familjare kanë një ndikim të madh në angazhimin e tyre profesional si punonjëse të medias, ndërsa 50 përqind sosh pranuan se ka një lloj ndikimi.



Duke marrë parasysh se si barra e punës së papaguar dhe e prindërimit bie në mënyrë disproporcionale mbi supet e grave kosovare në krahasim me partnerët e tyre burra - për nënat beqare është edhe më keq - nuk është çudi që të dhënat e përmbledhura tregojnë se 97 përqind e atyre që janë përgjigjur se përgjegjësitë familjare ndikojnë 'shumë' në karrierën e tyre, janë kryesisht të martuara dhe kanë fëmijë.

Kjo përforcohet edhe përmes përgjigjeve në pyetjen nëse mendojnë se karriera e tyre ka pësuar për shkak se janë të martuara dhe nëna, për të cilat pak më pak se 70 përqind sosh u përgjigjen me "Po".



Gratë në Kosovë ende kryejnë shumicën e detyrave shtëpiake dhe të kujdesit për fëmijët, edhe kur të dy prindërit punojnë me orar të plotë, gjë që sipas të anketuarave ka penguar rrugëtimin e tyre gazetaresk dhe ndonjë përparim të rëndësishëm.

Dëshmitë:

“Duke qenë grua dhe nënë u jam nënshtruar gjithmonë jo vetëm standardeve të dyfishta, por barrës së të mbajturit të dy e më shumë punëve, duke përfshirë edhe obligimet për kujdesin ndaj fëmijës dhe shtëpisë. Kjo ka bërë që koha ime për përparim profesional dhe në karrierë të jetë më e pakët dhe ecja në një hap më të ngadaltë. Pa përfshi këtu edhe ndikimin e drejtpërdrejtë të kërcënimeve dhe presionit në punën time si gazetare që ka ndikuar jo vetëm në kufizimin tim, por edhe në raportet në familje.”

“Përgjegjësia e kujdesit ndaj fëmijës bie plotësisht mbi nënën. Marrë parasysh këtë fakt ke ngecje në karrierë sepse s’mund të jesh e pranishme kur ke obligime të panumërta familjare.”

“Gazetaria është fushë që të jep shumë mundësi për avancim profesional. Shumë shpesh këto mundësi implikojnë udhëtime jashtë vendit. Duke qenë nënë e dy fëmijëve, me dhjetëra raste kam heq dorë nga to për shkak të angazhimit familjar. Tash fëmijët janë rritur është ndryshe, por kur shoh mbrapa e kuptoj sa shumë raste i kam humbur.”

“Për faktin se me duhet të arrijë në shtëpi në kohën kur fëmija kthehet nga shkolla apo kur i përfundon orari i kopshtit/shkollës, unë ndonjëherë shumë plane që i kam për t’i realizuar në profesionin tim i lë anash. Përfshihem sa më pak në trajnime e tryeza diskutimesh në mënyrë që të mos “humbas” kohë, sepse kam familjen në shtëpi që presin prej meje kujdesin.”

“Vëmendja dhe koha ka qenë e ndarë në mes punës dhe përgjegjësisë sime si nënë. Po të mos isha nënë e 3 fëmijëve do të kërkoja më shumë nga vetja, por duke qenë se kam edhe obligime të tjera gjithnjë llogaris çfarë mund të bëj që mos t’i dëmtoj fëmijët me mos prezencën time në shtëpi, dhe kjo në mënyrë direkte apo indirekte ka ndikuar në karrierën time.”

“Që nga momenti që kam qenë shtatzënë e kam pasur shumë të vështirë që të gjej një punë që do t’i përshtatej edhe jetës profesionale, po edhe asaj private, në shumicën e vendeve të punës kërkohet të bëhet ose njëra ose tjetra!”

“Për shkak të fëmijës shumë herë jam detyruar të tërhiqem nga mbulimi i një ngjarje apo trajnime profesionale sepse s’kam pasur ku ta lë fëmijën.”

“Në momentin që martoheni konsideroni që tashmë do të keni obligime më të mëdha familjare, qe duhet të përkushtoheni për fëmijët e mundshëm që do të vijnë, prandaj në njëfarë forme konsideroheni se nuk mund te keni përkushtimin për punë si më parë. Që në momentin që lidhni martesë, diskriminoheni.”

“Janë disa arsye të cilat mund të shpjegohen nga perspektiva sociologjike. E para, është sepse obligimet familjare të kufizojnë në zhvillimin e karrierës sidomos në profesionin e gazetarisë i cili është dinamik dhe ndryshon vazhdimisht si në situata ashtu edhe në orarin e punës. E dyta, është sepse mediat dinë të jenë biznese komerciale të cilat kur vjen puna te përfitimi financiar i injorojnë parimet profesionale dhe kërkojnë elemente mediokre te një profesionist.”

“Patjetër që ndikon. Pavarësisht përpjekjeve që të dyja të bëhen në mënyrën më të mirë të mundshme, kur vjen çështja te fëmijët është ndryshe, sidomos kur janë ende të vegjël. Kohën kur do të kishe mundësi të ndiqje seminare të ndryshme, kurse të ndryshme e nivele tjera të shkollimit (doktoratë), këtë pjesë ua kushtoj fëmijëve. Pra, gjithçka duhet të planifikohet. Fillimisht, pres të rriten fëmija, e pastaj t’i kthehem prapë avancimit personal profesional. Jo që nuk arrin njeriu t’i bëjë të dyja njëkohësisht, edhe ngritjen e avancimit permanent profesional dhe të jesh nënë, mirëpo personalisht nuk dua t’u mungojë fëmijëve, deri në një kohë kur mendoj se janë rritur mjaftueshëm.”

“Në ndërdijen e punëdhënësve, një grua e martuar është e kufizuar detyrimisht, në të gjitha aspektet.”

“Kam një fëmijë me zhvillim të vonshëm në të folur dhe më duhet të punoj shumë me të. Prandaj kam ngecur në karrierë.”

“Koha për vetën është limituar, mundohem të arrij t’i përfundoj punët e shtëpisë dhe të arrij me kohë në punë.”

“Duke qenë nënë, e kisha te nevojshme të mbaja vetëm ndërrimin e paradites. Kam humbur shumë mundësi për një vend pune qysh në intervistë për faktin që punëdhënësi nuk ma mundësonte të mbaja vetëm ndërrimin e paradites, ose të mbaja ndërrimin e pasdites dy ditë në muaj. E di se kjo mund të jetë e padrejtë ndaj kolegëve tjerë që nuk kanë fëmijë, por e kam provuar që të ndërroja orarin tim të paradites me kolegët tjerë në kompensim të një shumë parash, vetëm e vetëm që të mund të bëja karrierë, edhe pse kjo kushton goxha shumë.”

“Njeriu ka prioritetet e tij në jetë, sigurisht e ka shumë të rëndësishme karrierën, por kur je nënë, prioriteti yt janë fëmijët e tu, para karrierës e gjithçkaje tjetër.”

STIGMATIZIMI DHE PARAGJYKIMET: “KALOJ SHUMË KOHË ME BURRA”

Edhe pse nuk kishte pyetje konkrete nëse si gazetare, ato ndihen të stigmatizuara apo të paragjykuara, disa gazetare thanë se karriera e tyre u ndal për shkak të stereotipeve gjinore dhe roleve të pritshme tradicionale, gjë që nuk lejon një punë që kërkon shumë punë në terren dhe takime me grupe të ndryshme njerëzish.

Dëshmitë:

“Mendoj karriera ime, natyra e punës sime, dhe faktit se bëjë punë me shumë angazhim ka mjaft paragjykime. Ka paragjykime për gratë në media në përgjithësi. Një burrë me të cilin pata dalë një kohë më pati thënë se “Unë kaloja kohë më tepër se duhet me burra”. Pra në këtë drejtim mendoj që ka ndikuar në jetën personale time forma se si jam trajtuar nga shoqëria si pasojë e paragjykimeve që janë ekzistente.”

“[Karriera ime ka pësuar] për shkak se familja e bashkëshortit nuk e ka kuptuar punën time si duhet.”

PUSHIMI I LEHONISË: MË KA LËNË PRAPA

Ligji aktual i Punës në Kosovë parasheh që gratë kanë të drejtë në 12 muaj pushim të lehonisë. Punëdhënësit janë të detyruar të paguajnë 70 përqind të pagës gjatë gjashtë muajve të parë të pushimit; qeveria paguan për tre muajt në vijim në normën 50 përqind të të ardhurave mesatare në Kosovë kosovare; tre muajt e fundit mund të merren pa pagesë.

Ndërkohë, baballarët kanë të drejtë të marrin vetëm deri në tre ditë pushim të paguar të atësisë, dhe deri në dy javë pushim pa pagesë. Aktivistet për të drejtat e grave kanë theksuar për vite të tëra se këto dispozita i përforcojnë rolet tradicionale gjinore, ku punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët shihen kryesisht si punë e grave. Ata(o) po ashtu avokojnë që shteti të marrë barrën e pagesës së pushimit të lehonisë, pasi dispozitat aktuale po i mbajnë gratë jashtë tregut të punës. Dhe për ato që kanë një vend pune, diskriminimi është përhapur gjerësisht sa i përket zbatimit të ligjit.

Ky kontekst është shumë i rëndësishëm për të kuptuar se deri në çfarë mase sektori i medias, i cili po ashtu për vite të tëra e ngre këtë temë si çështje me interes publik, po i respekton të drejtat e punonjësve të saj.

Shumica e të anketuarave thanë se punëdhënësi i tyre në sektorin e medias ua respekton të drejtën ligjore punonjësve të vet për pushim të lehonisë.

15

A e respekton punëdhënësi juaj të drejtën ligjore të punëtorëve për pushim të lehonisë?

6.3%


Jo

8.8%

Nuk e di

85%

Po



Por një pasqyrë më e detajuar e të anketuarave sugjeron se situata se si punëdhënësit e trajtojnë pushimin e lehonisë mund të jetë më e ndërlikuar dhe e zyrtë. Gratë që janë nëna mund të ketë më shumë gjasa të përgjigjen me “Po” krahasuar me ato që nuk kanë fëmijë. Të anketuarat që nuk kanë përvojë personale me ligjin e amësisë, mund të ndihen më të paqarta dhe nuk janë të sigurta për të arritur në përfundimin se si punëdhënësit e tyre i trajtojnë punëtorët që ishin bërë nëna.

53.8 përqind e atyre që janë përgjigjur me “Po”, se punëdhënësi i tyre nuk e respekton të drejtën ligjore për pushim të lehonisë, janë nëna. Nga ana tjetër, 75 përqind e atyre që janë përgjigjur me ‘Nuk e di’ dhe 66 përqind e atyre që janë përgjigjur me ‘Jo’, nuk kanë fëmijë.

Edhe pse të anketuarat nuk dhanë ndonjë citim të drejtpërdrejtë të asaj se si punëdhënësit nuk e respektojnë të drejtën e tyre për pushim të lehonisë, disa dëshmi ilustrojnë se si pushimi i lehonisë e dëmton karrierën e grave. Sa më larg të jenë ato nga puna me pagesë, aq më pak ka gjasa që të promovohen ose të bëjnë ndonjë përparim.

Dëshmitë:

“Në kohë pushimi të lehonisë, kam mbetur prapa me avancim.”



“Për shkak të pauzës së gjatë, kam përshtypjen se publiku e harron veprën dhe punën e bërë gjatë viteve.”

“Karriera ime ka pësuar shumë, sepse në momentin që më ka përfunduar kontrata vjetore unë kam qenë shtatzënë dhe nuk më është vazhduar më kontrata e punës.”

PORTRETIZIMI I GRAVE NË MEDIA

Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e grave në media, statistikën janë plotësisht në përputhje me gjetjet globale: shumica e grave të anketuara treguan një reagim të lartë ndaj përfaqësimit të barabartë gjinor dhe produksionit mediatic gjithëpërfshirës.


69.8 përqind sosh mendojnë se gratë janë më pak të përfaqësuara, 98.5 përqind besojnë në rëndësinë e përfaqësimit të barabartë në media dhe 84.9 përqind e marrin në konsideratë përfaqësimin e barabartë në punën e tyre (p.sh., kur i zgjedhin bashkëbiseduesit e tyre). 70 përqind e të anketuarave shohin një korrelacion ndërmjet statusit të grave në redaksi dhe portretizimit të tyre në media.



18

Në punën tuaj, a i kushtoni vëmendje përfaqësimit të barabartë (p.sh. Kur i përzgjedhni bashkëbiseduesit)?

15.1%
Jo




84.9%
Po

19

A ndikon statusi i grave nëpër redaksi në atë se si dhe se sa do të përfaqesohen gratë në media?

31.7%
Jo



68.3%
Po

Dëshmitë:

“Nuk mund të ketë mbulim të mirëfilltë të ngjarjeve pa e marrë perspektivën e atyre që i takojnë gjysmës së popullatës, prandaj është kyçe që gratë të dëgjohen. Pos kësaj, mënyra se si gratë ndikohen nga politikat e ligjet e ndryshme është shpeshherë plotësisht ndryshe nga ajo e burrave, pikërisht për shkak të mentalitetit patriarkal të rrënjosur në mënyrën e funksionimit dhe mendimit institucional – prandaj pikëpamjet e grave janë qenësore për ta informuar publikun drejt për atë që ndodh rreth nesh.”

“Nëse tentojmë të kemi gjithë përfshirje të opinioneve dhe perceptimeve që kërkojmë, atë nuk e arrijmë pa përfshirjen e të gjitha kategorive gjinore dhe shoqërore.”

“Mungesa e figurës së gruas, veçmas në ekranet televizive (debate) vërehet qartazi dhe një gjë e tillë ndodh pikërisht për shkak të stigmatizimit/ofendimit të grave që marrin guximin të dalin në debate me burra! Kjo gjë ndodh për shkak të mosdhënies së hapësirës në të gjitha sferat, që i pengon pastaj ato të shfaqen në ekrane. Vetë kam qenë disa herë në situata të tilla, kur në emisione kam ftuar politikanë gra, ato kanë hezituat të vijnë shpeshherë, përpos në rastet kur ishin të vetme në intervistë, pra pa praninë e burrave politikanë, që shpesh herë dinë t'i ofendojnë rëndë ato.”

“Gratë janë të përfaqësuara në media në kuptimin që ka më shumë gazetarë se gazetarë, por në pozita udhëheqëse mbizotërojnë burrat. Nëse nuk jam gabim, vetëm dy medime kanë kryeredaktore.”

“Fatkeqësisht gjatë përvojës time në televizion, bashkëbiseduesit janë shumica burra. Është vështirë të gesh gra që dalin dhe flasin për çështje të caktuara.”

“Është shumë i rëndësishëm përfaqësimi i barabartë, për arsye edhe të respektimit të të drejtave të grave dhe burrave.”

“Duke u nisur nga fakti që media ndikon jashtëzakonisht shumë në perceptimin e publikut për realitetin. Atë që media e prezanton, ajo merret si e mirë dhe si e drejtë nga publiku. Kjo ka të bëjë edhe me edukimin medial, gjë që ndikon shumë tek të rinjtë dhe mendimet e tyre se si të veprojnë dhe të sillen me gjininë e kundërt në të ardhmen.”

“Si në secilin sektor, është e domosdoshme që gratë të përfaqësohen njësoj. Media besoj është sektori që si natyrë pune zhvillon, fuqizon dhe promovon gruan dhe të drejtat e saj.”

“Përfaqësimi i barabartë në media i kontribuon mbi të gjitha luftës për barazi gjinore.”

“Barazia gjinore është e rëndësishme në vendet e punës, jo vetëm se është ‘gjëja e drejtë për t’u bërë’, por sepse lidhet gjithashtu me zhvillimin e përgjithshëm. Qasja e barabarte ndikon në përmirësimin e produktivitetit, avancimin e të drejtave të grave dhe në zvogëlimin e hendekut të pabarazisë ndërmjet gjinive.”

“Sepse sa më shumë këndvështrime të ndryshme prej njerëzve të ndryshëm kontribuon në gazetari më të mirëfilltë.”

“Sepse për çdo temë duhet të kihen parasysh dy anët, dy mendimet e të dy gjinive, në çfarëdo situatë. Kësisoj krijohet një pasqyrë më e qartë e problemeve me të cilat ballafaqohen si gratë, ashtu edhe burrat.”

“Përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave në media është i rëndësishëm meqenëse mediat në njëfarë forme e formësojnë shoqërinë, përmes përmbajtjes që ofrojnë, atëherë është shumë me rëndësi që kjo përmbajtje të përfaqësojë edhe barazinë gjinore, larminë dhe gamën e opinionëve dhe audiencave të tyre.”

“Përfaqësimi i barabartë është i nevojshëm sepse e edukon shoqërinë se gratë kanë të drejtë të marrin pjesë sa edhe burrat, ofron perspektiva të ndryshme mbi të cilat opinioni publik ndërton mendimin e tij bazuar në një shpërndarje të barabartë. Andaj edhe është i rëndësishëm pasi që pikën kryesore e ka që i mëson/e edukon shoqërinë duke parë sa gra aq burra në media dhe kjo indirekt u krijon atyre mendimin se gratë mund të merren dhe të jenë pjesë e tematikave të ndryshme, e njëjta gjë vlen edhe për burrat.”

“Nuk mund të flas me siguri për arsyet pse gratë nuk janë barabartë të përfaqësuara në media, por besoj se ka të bëjë kryesisht me paragjykimin që kanë ndaj grave, në njohurit që ato kanë për çështje të caktuara. Sa i përket punës sime, mundohem të bëjë më të mirën, por shpesh herë është vështirë e realizueshme për shkak edhe të mosgatishmërisë së tyre për të folur për temat që kryesisht i trajtoj. Dhe padyshim që përfaqësimi i barabartë është i rëndësishëm, jo vetëm në media, por në secilën sferë.”

“Si në çdo fushë është me rëndësi të ketë barazi dhe të dëgjohet zëri i të dyja gjinive, posaçërisht në shoqërinë tonë ku jemi të vetëdijshëm që pozita e gruas nuk është në nivelin e dëshirueshëm. Përfaqësimi i barabartë lidhet ngushtë me emancipimin dhe avancimin e pozitës së gruas në shoqëri.”

“Nëse krahasohet përfaqësimi në media, gratë janë shumë më pak të përfaqësuara, sidomos në TV. Shumica e paneleve të emisioneve, janë të mbushura me burra. Në disa raste nuk u jepet mundësia, por ka edhe raste kur ato hezitojnë të dalin e të deklarohen për çështje të tilla, meqë pastaj linçohen për deklaratat e tyre. E kishim rastin e fundit të aktivistes Zana Avdiu, e cila për një deklaratë që dha, mori me mijëra kërcënime e u linçua.”

“Nuk mund të kem barazi gjinore të bashkëbiseduesve sepse në shume raste përfaqësuesit që më duhen në intervista rastisin të jenë meshkuj. Edhe me qytetarët në rrugë, zakonisht gratë, hezitojnë të flasin.”

“Burrat po janë shumë më prezentë në media në intervista dhe debate. Kjo gjë shkakton anim edhe për informacione, por përforcon edhe më shumë seksizmin në shoqërinë tonë.”

“Përfaqësimi i barabartë i burrave dhe grave është shumë i rëndësishëm për shkak se ofron hapësirë e barabartë për të treguar aftësitë e të dyja anëve.”

“Nuk mendoj se përfaqësimi gjinor nëpër media është në nivel të kënaqshëm, pasi rasti specifik, kemi shumë emisione e debate televizive të caktuara, ku numri i përfaqësuesve gra është shumë më i ulët në krahasim me burrat, sidomos në fushën e politikës, gjyqësisë dhe atë të ekonomisë. Ka edhe gra, politike, ekonomiste, juriste etj., shumë të suksesshme, por që mendoj se nuk u jepet hapësira e mjaftueshme në media të argumentojnë proceset politike apo zhvillimore në vend, gjë që është për t'u shqetësuar.”

“Më së shumti në media dëgjojmë për gratë kur i vrasin apo i dhunojnë. Gratë kanë nevojë të jenë të përfshira aq sa edhe burrat, edhe në sferën publike, e si pjesë e saj e pandashme janë mediat.”

“Niveli i pjesëmarrjes dhe ndikimit të grave në media ka implikime për përmbajtjen mediatike: gratë profesioniste të medias ka më shumë gjasa t'i pasqyrojnë nevojat dhe perspektivat e grave të tjera sesa kolegët e tyre burra.”

“Në redaksinë ku unë punoj, ato përfaqësohen në mënyrë të barabartë. Për sa i përket përfaqësimit të barabartë në storiet që ju zhvillonin, është e pamundur të zgjedhësh gjininë për shkak të dinamikës së punës, pasi prioritet është pranimi për të qenë pjesë e stories dhe aftësive të tyre. Nuk e kemi luksin të kujdesemi për përfaqësim të barabartë, për shkak të dinamikës së punës dhe afatit për të përfunduar një storie. Për sa i përket përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në media, veçanërisht në hierarkinë drejtuese, mendoj se është e rëndësishme.”

“Po, mendoj se është shumë i rëndësishëm pasi që vlerësoj se do të duhej të ishim një pasqyrë e mirë e organizimit dhe një shembull për shoqërinë, duke qenë se jemi një ‘mjet’ i rëndësishëm i jetës publike.”

“Ngase kjo do të pasqyronte edhe aspektin demografik. Pastaj do të inkurajonte rritjen e numrit të grave edhe në pozita vendim-marrëse. Natyrisht, krahas kësaj do të ndodhte edhe emancipimi më i madh social.”

“Gratë janë më pak të përfaqësuara sepse edhe kur i ftojme për intervista, ato refuzojnë shumë shpesh. Kjo ndodh edhe shpesh për faktin se kanë edhe obligime familjare, mendohej gjithmonë që të bëjmë balancim gjinor të personave që i intervistojmë p.sh edhe në rastin e VOX-ave nëse na janë përgjigjur dy burra tash do t'i intervistojmë dy gra.”

“Përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave është i nevojshëm sepse kështu ka një balancim mes mendimeve dhe përvojave të dy gjinive të ndryshme.”

“Emisionet e politikës në Kosovë udhëhiqen më shumë nga moderatorë dhe producentë burra, e që është gabim, njëjtë siç është gabim që emisionet e shoubizit udhëhiqen nga vajzat/gratë.”

“Sepse mediat kanë përgjegjësi të pasqyrojnë barazinë gjinore.”

“Gratë janë të prira të punojnë më shumë, por kur vjen tek punët e rëndësishme ato u besohen burrave.”

“Kosova si shoqëri patriarkale e ka ende të vështirë të pranojë që gruaja sot ka avantazhe dhe zhvillim të jashtëzakonshëm intelektual. Fatkeqësisht, në media, gruaja përdoret vetëm si aksesori në studio. Kemi shembull Kampionatin Botëror të Futbollit kur në studio gratë kanë qenë aty vetëm për shkak të bukurisë dhe në numër të vogël në krahasim me burrat. Anën tjetër, në emisionet informative/politike shumë pak gra janë drejtuese të emisionit. Mos të flas si mysafirë (analiste).”

“Në media më shumë hapësirë u jepet grave në pozita më të ulëta, derisa ato më të larta udhëhiqen nga burrat. Kemi parë që shumica prej emisioneve kryesore në medie të cilat kanë të bëjnë me politikë, udhëhiqen nga burrat. Po ashtu në mediat ku kam punuar deri tani mund të them se 9.9 përqind e redaktorëve dhe kryeredaktorëve kanë qenë burra. Andaj, duke e parë që gratë janë treguar shumë herë të suksesshme në këtë profesion, për çka flasin më së miri edhe çmimet që kanë fituar ato, do të ishte shumë e rëndësishme që të ketë përfaqësim të barabartë edhe në pozita më të larta.”

“Fatkeqësisht gjykimi ndaj punës së grave dhe burrave në gazetari nuk është i barabartë. Nëse një grua realizon një storje e cila paraqet një problematikë, ajo gjykohet se nuk është e denjë për të realizuar atë, nuk është “punë” e saj të merret me çështje shtetërore, përderisa për burrat kjo është gjithçka në rregull. Në debate, nëse një gazetarë jep një kritikë, ajo më pas kritikohet e bullizohet vetëm për shkak të gjinisë. Fatkeqësisht tek ne mendimet e grave gjithmonë paragjykohehen, nuk lidhen direkt me temën e trajtuar, por me atë se si ajo grua po e trajton, e posaçërisht në gazetari sepse është profesion publik. E tashmë kur puna jonë prezantohet në rrjete sociale, vërehen dukshëm komentet e tilla edhe publikisht. Në anën tjetër, burrat komentohen në përgjithësi vetëm për atë se çka flasin!”

“Jo çdo herë i kushtoj vëmendje përfaqësimit të barabartë të bashkëbiseduesve, kjo shkak i temave që trajtoj. Përzgjedhjen e bashkëbiseduesve e bëj vetëm në aspektin profesional, por mundohem që të kem edhe gra bashkëbiseduese, por jo çdoherë mundesh, shkak i hezitimit të tyre për të folur para kamerës. Është me rëndësi që gratë të kenë më shumë vetëbesim në profesionin që e kanë dhe të marrin guxim që të flasin për çështje për të cilat kanë njohuri.”

“Pjesëmarrja e grave në media është motiv për vajzat e reja që t’i ndjekin ëndrrat e tyre - në njëfarë forme jep mesazhin se asgjë nuk është e pamundur.”

REKOMANDIMET

1. Vendosja ose përmirësimi i linjave telefonike ndihmëse dhe i sistemeve të ndihmës juridike në shoqatat e gazetarëve (për t'i inkurajuar gratë e angazhuara në media që t'i raportojnë rastet e dhunës).
2. Përmirësimi i bashkëpunimit me rrjetin e mentorimit të Këshillit Britanik (në mënyrë që gratë e reja të kenë mundësi të kërkojnë këshilla, të konsultohen për kushtet e punës dhe mjedisin e punës).
3. Të ftohen fakultetet, partitë politike, institucionet dhe organizatat joqeveritare që të përcjellin në media të dhënat kontaktuese të grave që mund të jenë bashkëbiseduese në reportazhe të ndryshme mediale.
4. Të ftohen gratë e angazhuara në media që të anëtarësohen në ndonjë nga shoqatat apo grupet mediatike të tipit “Gazetaret kundër dhunës”: nga njëra anë, kjo do t'i fuqizonte ato, ndërsa nga ana tjetër, do t'i frymëzonte ato që t'i inicionin masat që mund ta përmirësojnë statusin e tyre.
5. Të iniciohet, në rrjetet sociale, krijimi i grupit Gratë në Media - ku gazetaret, kameramanet, montazheret, fotoreporteret, të mund të ankohen, të informojnë dhe të ndërliken në rrjet.

MIRËNJOHJET

Anketa mbi Pozitën e grave të angazhuara në mediat kosovare është realizuar falë gatishmërisë, përkushtimit dhe kohës së 265 gazetarëve, redaktoreve, producenteve, fotografeve dhe prezantueseve gra, të cilat punojnë nëpër platforma të ndryshme mediatike në Kosovë.

Ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre në mënyrë anonime, duke mundësuar që për herë të parë të krijojmë një pasqyrë më të saktë të mundimeve, përpjekjeve dhe sfidave të tyre brenda redaksive e më gjerë.

Kontributi i tyre i thellë dhe i sigurtë do të shërbejë si dëshmi e rëndësishme nga e cila ne të gjithë mund ta fillojmë diskutimin për atë se “Si është të jesh grua në mediat kosovare?”

METODOLOGJIA

Për hulumtimin tonë përdorëm vetëm anketën online për të vlerësuar sa janë përfaqësuese pikëpamjet, qëndrimet dhe përvojat individuale, si dhe për të analizuar nëse ose si kryqëzohen këto të dhëna, për të përcaktuar dhe konfirmuar realitetet që i rrethojnë gazetarët dhe implikimet që ato kanë në vendin e punës. Me këtë anketë jemi përpjekur t'i shqyrtojmë rrethanat ku punojnë ato nga perspektiva gjinore.

Me anketën që përbëhej nga 40 pyetje, jemi përpjekur t'i përcaktojmë aspektet e mëposhtme:

- Ndërtimin e profilit të një gazetareje mesatare kosovare
- Fushat dhe temat të cilat ato i mbulojnë
- Gjendjen financiare
- Kushtet në vendin e punës
- Diskriminimin gjinor në vendin e punës
- Dhunën seksuale në vendin e punës
- Zbatimin e Ligjit të Punës, veçanërisht të nenit të Pushimit të Lehonisë
- Stërmundimet e gazetarëve që janë kujdestarë të familjes
- Reflektimet personale mbi barazinë gjinore dhe diskriminimin në vendin e punës
- Reflektimet mbi portretizimin mediatik të gjinisë

Ky hulumtim është kryer mes muajve gusht dhe dhjetor 2022 dhe anketa u është dërguar 265 punonjëseve gra të mediave në mbarë Kosovën. Në këtë anketë morën pjesë 250 të anketuara shqiptare të Kosovës dhe 15 serbe të Kosovës. Meqenëse rezultatet dhe pikëpamjet ishin të ngjashme ose të njëjta mes dy grupeve etnike të gazetarëve, analiza jonë përfundimtare është gjithëpërfshirëse dhe nuk është ndarë sipas përkatësisë etnike, me këtë anketë jemi përpjekur të përcaktojmë se si gjinia, dhe jo aspekti etnik, ndikon në kushtet e tyre të punës dhe në të drejtën të tyre për ta kryer punën e tyre me dinjitet të plotë.

Ne kemi përfshirë një gamë të gjerë punonjësish të medias të të gjitha moshave që punojnë në të gjitha platformat mediatike: nga Transmetimi Publik, tek TV Kombëtar, organizatat e lajmeve në internet, stacionet radiofonike, tek organizatat mediatike lokale dhe të komunitetit. Gazetarët e anketuar janë pjesë e organizatave të ndryshme mediatike, qyteza dhe qytete.

Studimi është kryer nga Dafina Halili me ndihmesën e Dion Krasniqit dhe Gentiana Sylejmanit.

RRETH ALVED-IT

Fuqizimi i zërave lokal për zhvillim të barabartë (ALVED) është një projekt 30-mujor i financuar nga Fondi i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktet, Sigurinë dhe Stabilitetin dhe i zbatuar nga një konzorcium organizatash i përbërë nga Peaceful Change initiative (Iniciativa për Ndryshim Paqësor), People in Need (Njerëzit në nevojë), Iniciativat Qytetare (Civic Initiatives, Serbi), Peer Educators Network dhe Aktiv (të dyja nga Kosova). Ky projekt synon të promovojë, eksplorojë, zhvillojë dhe zbatojë praktika inovative që mundësojnë vendimmarrjen pjesëmarrëse që është e suksesshme në kapërcimin e pengesave ndërmjet grupeve të ndryshme në Serbi dhe Kosovë, si dhe t'i angazhojë palët e interesuara të projektit në analizimin e kontekstit në të cilin zhvillohet kjo punë me një pikëpamje për të ndërmarrë veprime bashkëpunuese dhe strategjike për të kontribuar në një mjedis më të favorshëm për lulëzimin e demokracisë gjithëpërfshirëse dhe për të pasur një ndikim pozitiv në jetën e njerëzve të rëndomtë.



Ky studim është financuar nga UK AID prej Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, megjithatë, pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

RRETH PCI

Iniciativa për Ndryshim Paqësor (PCI) punon bashkë me shoqëritë për ta parandaluar ose zvogëluar dhunën që shkaktohet nga ndryshimet radikale dhe përçarëse. Ne synojmë t'i zbusim efektet e dhunës në jetën e njerëzve, duke i ndërtuar themelet për paqen dhe stabilitetin afatgjatë.

Ne drejtojmë programe në Lindjen e Mesme (Siri), Afrikën Veriore (Libi) dhe Evropë (Ukrainë, Ballkanin Perëndimor, Kaukazin Jugor). Puna jonë fokusohet në:

- Forcimin e aftësive të liderëve lokalë dhe kombëtarë të cilët janë në gjendje të ndërtojnë marrëdhënie përtej ndasive të konfliktit;
- Mbështetjen e liderëve lokalë dhe aktivistëve të shoqërisë civile në veprime praktike për ta zvogëluar dhunën dhe për ta përmirësuar ndjenjën e sigurisë së komuniteteve;
- Nxitja e partneriteteve të punës ndërmjet komuniteteve dhe autoriteteve lokale, si dhe ndërmjet grupeve të ndryshme lokale dhe kombëtare përtej ndasive të konfliktit, për ta ndërtuar besimin në një të ardhme të përbashkët;
- Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile për t'u lidhur, shkëmbyer përvoja dhe për të qenë pjesë e vendimmarrjes;
- Zhvillimi dhe shkëmbimi i mjeteve dhe metodologjive praktike për ndërtimin e paqes;
- Këshillimin e agjencive, OJQ-ve, qeverive dhe kompanive ndërkombëtare për mënyrën si të arrihet një ndikim më i madh.



Peaceful
Change
initiative

Peaceful Change initiative

peacefulchange.org

UK Headquarters, 25B Lloyd Baker Street, London

Charity number: 1162997



www.facebook.com/peacefulchange.org



twitter.com/pci_org



uk.linkedin.com/company/peaceful-change-initiative